



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 gusht 2015
Nr. ref.: RK 825/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI32/15

Parashtrues

Shemdi Nishevci

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev.
nr. 188/2014, të 17 nëntorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Shemdi Nishevci nga Podujeva, të cilin e përfaqëson z. Ndue Thaçi, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 188/2014, të 17 nëntorit 2014 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), me të cilin u vërtetuan vendimet e gjykatave të instancave më të ulëta, sipas të cilave nuk kishte bazë ligjore për anulimin e vendimit të punëdhënësit. Aktgjykimi i kontestuar i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 15 janar 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës për barazi para ligjit, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dhe të drejtën e punës dhe ushtrimin e profesionit, siç garantohen me nenet 3 dhe 24.2, me nenin 31, me nenin 49 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenet 22 e 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 mars 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 21 prill 2015, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Bekim Sejdiu.
7. Më 13 maj 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kësaj kërkesë ia dërgoi Gjykatës Supreme.
8. Më 1 korrik 2015, Kryetarja emëroi vetveten anëtare në Kolegjin shqyrtues në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, mandati i të cilit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka përfunduar më 26 qershor 2015.
9. Më 8 korrik 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 1 shkurt 2009, parashtruesi lidhi kontratë pune (nr. 2188/0) me Korporatën Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi) në pozitën mbikëqyrës i rrjetit në Distriktin e Prishtinës.

11. Më 6 shtator 2010, punëdhënësi (Njoftimi nr. 118) informoi parashtruesin për shkëputjen e kontratës së tij të punës, për shkak të shkeljes serioze të detyrave të tij të punës.
12. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë te menaxheri i Distriktit të Prishtinës, duke kërkuar rishqyrtimin e njoftimit për shkëputjen e kontratës së punës.
13. Më 13 shtator 2010, punëdhënësi (Vendimi nr. 451), refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës.
14. Më 19 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, kundër vendimit të punëdhënësit për refuzimin e ankesës së parashtruesit.
15. Më 6 nëntor 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi, C. nr. 2046/2010), refuzoi padinë e parashtruesit si të pabazuar, duke u arsyetuar se *“ky veprim i paditësit edhe pse nuk është shkaktuar në vendin e punës po është shkaktuar në shtëpinë e tij paraqet, si shkelje të rëndë të detyrave të punës”*.
16. Më 6 nëntor 2012, parashtruesi kishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, për shkak të *“cenimit të rëndë të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”*.
17. Më 3 janar 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi, Ac. nr. 1572/2013) refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktgjykimin (C. nr. 2046/10) e Gjykatës Komunale, duke arsyetuar ndërmjet të tjerave se *“kur punëmarrësi bën vjedhjen, shkatërrimin, dëmtimin, ose shfrytëzimin e po autorizuar te pasurisë te punëdhënësit, punëmarrësit mund t'i shkëputet kontrata e punës”*.
18. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën Supreme, për shkak të *“shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të ligjit material”*.
19. Më 17 nëntor 2014, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Rev. nr. 188/2014) refuzoi revizionin si të pathemeltë.
20. Gjykata Supreme gjeti se *“...Shkëputja e kontratës së paditësit është bërë pas zhvillimit të procedurës paraprake ku më parë e paditura e ka njoftuar paditësin me shkrim për zhvillimin e procedurës ndaj tij, për shkelje të rëndë të detyrave të punës, prandaj pretendimet në revizion, për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, u refuzuan si të pabazuara”*.
21. Përveç kësaj, Gjykata Supreme gjithashtu konkludoi se *“aktgjykimi i kontestuar nuk përbën gabime që do të kishin kontestuar ligjshmërinë e Aktgjykimit”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pohon se vendimi i kontestuar ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 3 dhe 24.2 [Barazia Para Ligjit], me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, si dhe të drejtat e garantuara me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).
23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar kishte shkelur të drejtat e tij kushtetuese, sepse gjykatat e rregullta nuk i shqyrtuan drejt provat materiale.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata Kushtetuese së pari vlerëson nëse kërkesa e parashtruesit i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.
25. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

26. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) (d) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar”.

27. Për më tepër, rregulli 36 (2) i Rregullores së punës, parasheh:

“(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

28. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pohon që vendimi i kontestuar kishte shkelur të drejtat e tij për barazi para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë e të paanshëm dhe e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit.
29. Megjithatë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës thjesht deklaroi se ka pasur shkelje të të drejtave të tij kushtetuese, pa shpjeguar qartë se si dhe pse faktet që ai paraqiti përbëjnë shkelje të të drejtave kushtetuese të cilave ai u referohet.

30. Gjykata thekson se, për të pasur një rast që ngre shkelje kushtetuese, parashtruesi duhet të dëshmojë dhe të provojë se procedurat në gjykatat e rregullta, përfshirë Gjykatën Supreme, shikuar në tërësinë e tyre, nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur dhe në pajtueshmëri me kërkesat e një gjykimi të drejtë, apo që shkeljet e tjera të të drejtave kushtetuese të jenë kryer nga ana e Gjykatës Supreme, gjatë procedurave.
31. Gjykata konsideron se arsyetimi i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme është i gjerë dhe gjithëpërfshirës, dhe përmban arsyetim të detajuar se përse është dashur që revizioni të refuzohet si i pabazuar dhe të vërtetohen aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët; përkatësisht, për shkak se faktet ishin konstatuar në mënyrë të drejtë, nuk janë gjetur shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikim i gabuar i të drejtës materiale.
32. Për më tepër, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka dëshmuar dhe nuk ka provuar pretendimin e tij në baza kushtetuese; përkundrazi, ai vetëm ishte kufizuar në diskutimin për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, të cilat janë të natyrës së ligjshmërisë dhe bien nën juridiksionin e gjykatave të rregullta.
33. Në këtë kontekst, Gjykata nuk do të duhej të vepronte si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz vs. Spain* [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
34. Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë vetëm nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkesë të ketë pasur një gjykim të drejtë (Shih, ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).
35. Si përmbledhje, Gjykata, në rastin konkret nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub vs. Lithuania*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
36. Nga të gjitha arsyet e shtjelluara më lart, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1), (d) dhe 36 (2) (të Rregullores së punës, më 21 gusht 2015, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Vjosa Rama-Hajrizi